



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1037 prot.

Himarë, më 24.02.2022

V E N D I M

Nr. 13 datë 24.02.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E LINJAVE TË TRANSPORTIT QYTETËS DHE RRETHQYTETËS TË UDHËTARËVE NË BASHKINË E HIMARËS, KUÇ - HIMARË - KUÇ DHE HIMARË - HORË - VRANISHT - HIMARË, MËNYRËN E ORGANIZIMIT TË SHËRBIMIT DHE PËRCAKTIMIN E STACIONEVE TË QËNDRIMIT TË AUTOMJETEVE TË SHËRBIMIT NË KËTO LINJA**

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronjat "a" dhe "b", nenit 23, pika 6, nenit 54, shkronja "k", nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar; nenit 8, nenit 121, pika 1, nenit 124, pika 1, nenit 125 dhe nenit 126, pika 1, të Ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar; neneve 13, 14, 15, 17 dhe 19 të ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 për "Transportet Rrugore", i ndryshuar; udhëzimit nr.15, datë 24.07.2007 .Këshilli i Bashkisë Himarë në mbledhje e tij të dates 24.02.2022 pasi shqyrtoi matërialin e përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mirëmbajtjes

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë rrjetin e linjave qytetëse të transportit të udhëtarëve:

**Linja nr.1:** Kuç - Himarë- Kuç

**Linja nr.2:** Himarë - Horë -Vranisht- Himarë

2. Rrjeti i linjave qytetëse të ketë inteneraret dhe stacionet si më poshtë:

**Linja nr.1:** Kuç- Himarë- Kuç

Stacioni nr.1: Qendra e fshatit Kuç  
Stacioni nr.2: Rruga kryesore Potam  
Linja nr.2: Himarë - Horë -Vranisht- Himarë

Stacioni nr.1: Rruga kryesore Potam  
Stacioni nr.2: Qendra e njësisë administrative Horë- Vranisht

3. Orari i fillimit dhe mbarimit të shërbimit për linjat e transportit do të jetë si më poshtë vijon:

Linja nr.1: Kuç- Himarë- Kuç

Nisja nga Qendra e fshatit Kuç në orën 06.30.  
Kthimi nga Himara, rruga kryesore Potam, në orën 13.30.

Linja nr.2: Himarë - Horë -Vranisht- Himarë

Nisja nga Himara, rruga kryesore Potam, në orën 06.30.  
Kthimi nga Horë -Vranishti, rruga kryesore Potam, në orën 13.00.

4. Ngarkohet drejtoria e shërbimeve publike dhe mirëmbajtjes dhe drejtoria juridike për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

**Sekretari**  
**Elena Memushaj**

**Kryetari**  
**Dhimitër Kapaj**

